



REPUBLIKA E MAQEDONISË SË VERIUT
AGJENCIA E SHËRBIMEVE MEDIATIKE AUDIO DHE AUDIOVIZUALE

PA1 Nr.08-369

24.11.2023

Shkup

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1) nënparagrafi 20, nenin 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.42/20 dhe 77/21), në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së Punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Teksti i pastruar) nr.ark.01-3732/1 datë 29.7.2019, njoftim për ndërprerjen me transmtim të programit televiziv nga Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, nr.ark.yni 08-4257/1 datë 15.11.2023., Deklaratë nga Angellçe Zdravkin – drejtues dhe themelues/pronar i vetëm i transmetuesit SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles – e noterizuar UZP nr.4663/2023 datë 20.11.2023. (nr.ark.yni 08-4257/2 datë 20.11.2023.) dhe Konkluzioni ark.nr 02-4325/12 datë 23.11.2023., Këshilli i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në seancën e 38-të mbajtur më datë 23.11.2023, solli:

Aktvendim
për fshirje nga regjistri i radiodifuzerëve

1. Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, FSHIHET nga regjistri i radiodifuzerëve.
2. Ky aktvendim botohet në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut" dhe në uebfaqen e Agjencisë.
3. Ky aktvendim hyn në fuqi menjëherë.

A r s y e t i m

Shoqëria Tregtare Radiodifuzive (SHTR) TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, është posedues i lejes për transmetim televiziv PA1 nr.08-50 datë 5.1.2015, e vazhduar për 3 vjet (nga 05 janar 2024 deri më 04 janar 2027), me Vendim PA1 nr.08-258 datë 15.8.2023, për transmetim nëpërmjet rrjetit publik të komunikimit elektronik që nuk shfrytëzon resurse të kufizuara, në nivel lokal në zonën e (Komunës së Velesit, Komunës së Çashkës dhe Komunës së Gradskos), shërbim programor televiziv me format të përgjithshëm në të cilat llojet e programeve të përfaqësuara realizojnë të tri funksionet mediatike, në gjuhën maqedonase.

Më datë 15.11.2023 SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, në mënyrë elektronike në adresën zyrtare e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (Agjencia) dorëzoi Njoftim, nr.ynë ark.08-4257/1 datë 15.11.2023, që për shkak të paarsyetimit ekonomik, SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, ndërpret transmetimin e programit televiziv. Lidhur me Njoftimin e cituar, Agjencia më 17.11.2023, në adresën elektronike zyrtare të transmetuesit të regjistruar si informacion kontakti në Regjistrin Qendror të RMV-së, adresa elektronike e cila regjistrohet në regjistrin e radiodifuzerëve të Agjencisë, e ka njoftuar në mënyrë elektronike transmetuesin në fjalë se në përputhje me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit për

Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV) është e nevojshme të dorëzojë deklaratë të noterizuar e dhënë nga drejtuesit, i cili është edhe themeluesi/pronar i vetëm i transmetuesit Shoqëria Tregtare Radiodifuzive TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, në të cilën detyrimisht duhet të thuhet se transmetuesi SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, ndërpret transmetimin e programit televiziv, duke specifikuar datën e saktë të ndërprerjes së transmetimit të programi televiziv.

Më datë 20.11.2023 në mënyrë elektronike, në adresën zyrtare të postës elektronike e-mail (contact@avmu.mk) të Agjencisë nga SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, ishte dorëzuar Deklaratë e dhënë nga ana e Angellçe Zdravkin në cilësinë e drejtuesit dhe themeluesit/pronarit të vetëm të transmetuesit SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, (e noterizuar) UZP nr.4663/2023 datë 20.11.2023 (nr. ynë ark.08-4257/2 datë 20.11.2023), me të çka deklaroi se SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP, Veles nga data 22.11.2023 do të ndërpresë transmetimin e programit televiziv. Transmetuesi në fjalë nuk ka borxh ndaj Agjencisë.

Në pajtim me nenin 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale (LSHMAAV), leja për transmetim në radio ose televizion ndalon të vlejë sipas fuqisë ligjore dhe deklaratën me shkrim të poseduesit ku njofton Agjencinë se ka ndaluar transmetimin e programeve në radio dhe televizion. Për ndalim të vlefshmërisë së lejes për transmetim në radio ose televizion në bazë ligjore Këshilli nuk sjell vendim. Agjencia do të fshijë transmetuesin nga regjistri i transmetuesve nëse lejes i ka mbaruar afati sipas fuqisë ligjore (neni 85, paragrafi 2).

Në bazë të gjithë kësaj që u theksua më lart, dhe në bazë të nenit 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, si dhe deklaratës së dhënë nga Angellçe Zdravkin - drejtues dhe themelues/pronar i vetëm i transmetuesit SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, (e noterizuar) UZP nr.4663/2023 datë 20.11.2023, janë plotësuar kushtet ligjore për fshirjen e transmetuesit të SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, nga regjistri i radiodifuzerëve.

Në bazë të nenit 18, paragrafi (1), nënparagrafi 20, neni 23, paragrafi (1), nënparagrafi 4 dhe neni 85, paragrafi (1), nënparagrafi 2 dhe paragrafi (2) të LSHMAAV, deklarata nga Angellçe Zdravkin – drejtues dhe themelues/pronar i vetëm i transmetuesit SHTR TV ZDRAVKIN Angellçe Zdravkin SHPKNJP Veles, (e noterizuar) UZP nr.4663/2023 datë 20.11.2023. (nr.ynë ark.08-4257/2 datë 20.11.2023), dhe në pajtim me nenin 10, paragrafi (5) të Rregullores së punës së Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale me nr. ark. 01-3732/1 datë 29.7.2019 dhe Konkluzioni me nr. ark.02-4325/12 datë 23.11.2023 është sjellë vendim si në dispozitiv.

**Agjencia e Shërbimeve Mediatike
Audio dhe Audiovizuale,
Kryetari i Këshillit
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v**

Këshillë juridike: Kundër këtij aktvendimi radiodifuzeri ka të drejtë padie për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente. Padia për ngritjen e kontestit administrativ paraqitet në afat prej 30 ditësh nga pranimi i vendimit.